



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 10 Mars 2021

Nr: 131

VENDIM

**PËR KTHIMIN PËR KORRIGJIM TË DOKUMENTACIONIT TË LISTËS  
SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR DEPUTET TË DEPOZITUAR NGA  
KOALICIONI “PARTIA DEMOKRATIKE – ALEANCA PËR NDRYSHIM (PD-PR-  
PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)”, “PD-AN” PËR  
ZGJEDHJET PËR KUVENDIN TË DATËS 25 PRILL 2021**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, neni 67, neni 72 dhe neni 73, pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe Udhëzimit nr.1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”,

V Ë R E J:

Koalicioni “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)”, “PD-AN” është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.

Në bazë të neneve 67 e 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, Koalicioni “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)”, “PD-AN” ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listave shumëmemërore për 12 zona zgjedhore.

Në bazë të nenit 73 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve verifikoi listat shumëmemërore të kandidatëve për deputet të koalicionit “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)”, “PD-AN” dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur. Në përfundim të procesit të verifikimit paraprak u konstatuan mangësi dhe mospërbushje të dokumentacionit si më poshtë:



1. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Tiranë**, nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke tejkalluar numrin e kërkuar me 6 kandidatë. Konstatohet se nuk është respektuar kuota gjinore sipas pikës 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, ka parregullsi në dokumentacionin e kandidatit sipas nenit 72 të Kodit Zgjedhor si dhe vërehen mospërbushje të kërkesave ligjore për depozitimin e formularëve të vetëdeklarimit sipas ligjit nr.138/2015;
2. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Elbasan**, nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke tejkalluar numrin e kërkuar me 6 kandidatë. Konstatohet se ka parregullsi në dokumentacionin e kandidatit sipas nenit 72 të Kodit Zgjedhor si dhe vërehen mospërbushje të kërkesave ligjore për depozitimin e formularëve të vetëdeklarimit sipas ligjit nr.138/2015;
3. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Berat**, nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke tejkalluar numrin e kërkuar me 3 kandidatë. Konstatohet se ka parregullsi në dokumentacionin e kandidatit sipas nenit 72 të Kodit Zgjedhor si dhe vërehen mospërbushje të kërkesave ligjore për depozitimin e formularëve të vetëdeklarimit sipas ligjit nr.138/2015
4. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Kukës**, nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke tejkalluar numrin e kërkuar me 6 kandidatë. Konstatohet se ka parregullsi në dokumentacionin e kandidatit sipas nenit 72 të Kodit Zgjedhor si dhe vërehen mospërbushje të kërkesave ligjore për depozitimin e formularëve të vetëdeklarimit sipas ligjit nr.138/2015;
5. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Gjirokastrë**, nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke tejkalluar numrin e kërkuar me 3 kandidatë. Konstatohet se ka parregullsi në dokumentacionin e kandidatit sipas nenit 72 të Kodit Zgjedhor si dhe vërehen mospërbushje të kërkesave ligjore për depozitimin e formularëve të vetëdeklarimit sipas ligjit nr.138/2015;
6. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Dibër**, nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke tejkalluar numrin e kërkuar me 3 kandidatë. Konstatohet se ka parregullsi në dokumentacionin e kandidatit sipas nenit 72 të Kodit Zgjedhor si dhe vërehen mospërbushje të kërkesave ligjore për depozitimin e formularëve të vetëdeklarimit sipas ligjit nr.138/2015;
7. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Shkodër**, nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke tejkalluar numrin e kërkuar me 9 kandidatë. Konstatohet se ka parregullsi në dokumentacionin e kandidatit



sipas nenit 72 të Kodit Zgjedhor si dhe mospërmbushje për depozitimin e formularëve të vetëdeklarimit sipas ligjit nr.138/2015;

8. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Durrës**, nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke tejkaluar numrin e kërkuar me 6 kandidatë. Konstatohet se ka parregullsi në dokumentacionin e kandidimit sipas nenit 72 të Kodit Zgjedhor si dhe mospërmbushje për depozitimin e formularëve të vetëdeklarimit sipas ligjit nr.138/2015;
9. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Fier**, nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke tejkaluar numrin e kërkuar me 6 kandidatë. Konstatohet se ka parregullsi në dokumentacionin e kandidimit sipas nenit 72 të Kodit Zgjedhor si dhe mospërmbushje për depozitimin e formularëve të vetëdeklarimit sipas ligjit nr.138/2015;
10. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Vlorë**, nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke tejkaluar numrin e kërkuar me 9 kandidatë. Konstatohet se ka parregullsi në dokumentacionin e kandidimit sipas nenit 72 të Kodit Zgjedhor si dhe mospërmbushje për depozitimin e formularëve të vetëdeklarimit sipas ligjit nr.138/2015;
11. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Korçë**, nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke tejkaluar numrin e kërkuar me 7 kandidatë. Konstatohet se nuk është respektuar kuota gjinore sipas pikës 6 të nenit 67 Kodit Zgjedhor, ka parregullsi në dokumentacionin e kandidimit sipas nenit 72 të Kodit Zgjedhor si dhe mospërmbushje për depozitimin e formularëve të vetëdeklarimit sipas ligjit nr.138/2015;

Në bazë të nenit 73, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dokumentacioni i depozituar kthehet për korrigjim, subjektit zgjedhor, koalicionit “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)”, “PD-AN”.

### PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 67, 72 dhe 73, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe Udhëzimin nr. 1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”,



## **V E N D O S :**

1. Kthimin për korrëgjim, sipas gjetjeve të renditura më sipër, të dokumentacionit për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për deputet, të koalicionit “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)”, “PD-AN”, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.
2. Dokumentacioni i korrëgjuar të depozitohet brenda datës 16.03.2021.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**



Data: 10 Mars 2021  
Nr. 131

Për kthimin për korrëgjim të dokumentacionit të listës shumëmemërore të Kandidatëve për Deputet të depozituar nga koalicioni Partia “Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD’) për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021